



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit/Departament Prostornog
Planiranja, Gradnje i Stanovanje/Department of Spatial Planing, Construction and Housing

UDHËZUES PËR FORMULARIN E APLIKIMIT PËR NËN-PROJEKTIN

“RINDËRTIMI I SHTËPIVE PRIVATE PËR FAMILJE APO INDIVIDËT E CENUESHËM”

NË KUADËR TË PROJEKTIT “BANIMI SOCIAL ADEKUAT” NË KOSOVË

1. Përmbledhje e projektit

Projekti “Banimi Social Adekuat” në Republikën e Kosovës zbatohet sipas Ligjit Nr. 08/L-302¹, i cili ratifikon Marrëveshjen e Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës (BZHKE/ CEB). Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ka caktuar Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) si zbatuese të projektit, e cila do të kryejë aktivitetet e Projektit përmes një Njësi të dedikuar për Menaxhimin e Projektit (NjMP), siç përcaktohet në Ligj.

Objekti kryesor i këtij Projekti është të zhvillojë një sistem menaxhimi të banimit social në Kosovë, të rrisë numrin e njësive të banimit social në vend dhe të përmirësojë kushtet e jetesës për individët dhe familjet që zotërojnë shtëpi që nuk i plotësojnë kushtet e jetesës.

¹ Ligji Nr. 08/L-302 Për Ratifikimin E Marrëveshjes Se Kredisë Në Mes Të Republikës Së Kosovës Përfaqësuar Nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin “Banimi Social Adekuat, e publikuar në faqen e Gazetës Zyrtare (gzk.rks-gov.net)

Kredia me vlerë totale prej 25 milionë eurosh do t'u ofrohet Komunave të Republikës së Kosovës, së bashku me një bashkëfinancim prej 12 milionë eurosh nga MMPHI.

Marrëveshja e kredisë përfshin disa pjesë kryesore:

- Komponenti 1 - Banimi Social Adekuat: Ky komponent synon zhvillimin e banimit social të përzier me qira, duke synuar familjet e varfra dhe të cenueshme me të ardhura të ulëta që nuk kanë zgjidhje banimi, si dhe zhvillimin e banimit të përballueshëm me qira për grupe të ndryshme me të ardhura të ulëta deri në mesatare, të cilat nuk mund të përballojnë çmimet e tregut për qira dhe/ose blerjen e banesës. Kjo përfshin ndërtimin e njësive të reja të banimit social, renovimin e njësive ekzistuese të banimit social, shndërrimin e ndërtesave ekzistuese në banim të ri social-të përballueshëm, si dhe blerjen e ndërtesave ose njësive të banimit për qëllime të banimit social-të përballueshëm me qira.
- Komponenti 2 – Ky komponent synon përmirësimin/renovimin e shtëpive ekzistuese në pronësi të familjeve të cenueshme të varfra deri me të ardhura të ulëta, me qëllim që ato të bëhen të përshtatshme për banim dhe më efikente në aspektin energjik.

Në rastet kur është teknikisht dhe ekonomikisht e arsyeshme, projekti mund të përfshijë edhe ndërtimin e shtëpive të reja.

Sipas kësaj thirrjeje për aplikime për nën-projekte, do të ofrohet mbështetje publike për RINDËRTIMIN E SHTËPIVE PRIVATE për familjet dhe individët më të cenueshëm dhe të varfër sipas Komponentit 2.

Kërkesat kryesore sipas këtij nën-projekti përfshijnë, ndër të tjera:

1. **Të drejtat mbi tokën dhe lejet:** Të sigurohet që të gjitha të drejtat pronësore, pasuritë e paluajtshme dhe lejet e nevojshme për zbatimin e nën-projektit të jenë të disponueshme në kohë të duhur.
2. **Pajtueshmëria:** Respektimi i të gjitha kërkesave të përcaktuara në Shtojcën 1 (Kushtet Specifike) të Ligjit Nr. 08/L-302².
3. **Prokurimi:** I gjithë prokurimi i punimeve dhe shërbimeve të financuara në kuadër të Projektit dhe nën-projektit të komunës do të jetë në përputhje me legjislacionin kombëtar që është në përputhje me rregullat e prokurimit të përcaktuara nga Banka e Zhvillimit të Këshillit të Evropës (BZHKE/CEB).
4. **Mbrojtja mjedisore dhe sociale:** Nën-projekti do të zbatohet në përputhje me Politikën për Mbrojtje Mjedisore dhe Sociale të CEB-it të vitit 2016, veçanërisht me masat mbrojtëse sociale dhe mjedisore, të cilat mund të konsultohen (këtu: <https://coebank.org> për më shumë informacione). Gjatë gjithë zbatimit, Projekti do të sigurojë përputhshmëri me dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe Kartës Sociale Evropiane.

² Ligji Nr. 08/L-302 Për Ratifikimin E Marrëveshjes Se Kredisë Në Mes Të Republikës Së Kosovës Përfaqësuar Nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin "Banimi Social Adekuat, e publikuar në faqen e Gazetës Zyrtare (gzk.rks-gov.net)

2. Kualifikimi

Pjesa në vijim paraqet rregullat për kualifikimin e aplikuesve dhe aplikimeve.

2.1 Kush mund të aplikojë?

Aplikimet mund të bëhen nga të gjitha Komunitetet e Kosovës të cilat kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me MMPHI.

2.2 Cilat nën-projekte janë të pranueshme?

Nën-projektet e Komunitetit të bashkëfinancuara nga CEB duhet të jenë në përputhje me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në Shtojcën 1, pika 3, Kriteret e Pranueshmërisë të Ligjit Nr. 08/L-302³ mbi Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës (CEB) për “Projektin e Banimit Social Adekuat” si më poshtë:

- Projekti do të financojë vetëm nën-projekte të vendosura në tokë pa asnjë pengesë dhe me të dhëna të gjurmueshme të pronësisë. Në mënyrë specifike, trualli në të cilin ndodhet shtëpia private duhet të ketë një certifikatë pronësie.
- Projekti nuk do të financojë nën-projekte që do të çonin në ndonjë zhvendosje (fizike ose ekonomike).
- Nën-projektet që ndodhen në zona me ndjeshmëri mjedisore, siç janë zonat e mbrojtura natyrore, nuk janë të pranueshme.
- Nën-projektet me rreziqe klimatike të pamënaxhuara nuk janë të pranueshme.

2.3 Kush janë grupet e synuara dhe kush është i/e kualifikuar për të përfituar potencialisht nga mbështetja e nën-projektit?

Grupi i synuar/përfituesit potencial janë familjet dhe individët të cilët, për shkak të rrethanave ekonomike, sociale, gjeografike ose fizike, janë në rrezik të lartë varfërie, dëmtimi ose diskriminimi.

Këta mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në: familje ose individë me gjendje të dobët ekonomike ose përfitues të ndihmës sociale; familje të mëdha me shumë fëmijë dhe familje me një prind/prind vetëushqyes; të papunët; të pastrehët; viktimat e dhunës në familje; viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore; gratë dhe burrat viktimat të luftës; familjet e dëshmorëve dhe personave të zhdukur të UÇK-së gjatë luftës; invalidët e UÇK-së që ndodhen në gjendje të rëndë ekonomike; invalidët civilë të luftës dhe familjet e ngushta të viktimave civile të luftës, personave të zhdukur dhe viktimave të trafikimit; të rinjtë; të moshuarit; personat me nevojë të veçanta; personat e zhvendosur dhe të riatdhesuar; komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian; fëmijët bonjakë apo pa përkujdesje prindërore pas daljes nga strehimoret; si dhe kategori të tjera të përcaktuara me ligj.

³ Ligji Nr. 08/L-302, Shtojca 1, e disponueshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=92330>

Situata ekonomike Numri i familjeve dhe individëve të cenueshëm që potencialisht do të përfitojnë nga nën-projekti do të vlerësohet bazuar në nivelet e të ardhurave, të kategorizuara si më poshtë:

Kategoria 1 – Të varfër ekstrem

Kategoria 2 – Të varfër

Ato përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, përfituesit e Skemës së Ndhmës Sociale për një minimum prej një viti, dhe përfituesit me të ardhura mujore deri në 100 euro për anëtar të familjes.

Komuna, në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale, do të vlerësojë gjendjen ekonomike të përfituesve duke përdorur verifikimin e të ardhurave ose një test varfërie, në përputhje me legjislacionin.

Kjo thirrje për aplikime për nën-projekte ofron mbështetje vetëm për rindërtim për familjet dhe individët e cenueshëm, shtëpitë private të të cilëve janë dëmtuar rëndë. Mbështetja publike për rindërtimin e shtëpive private do të ofrohet nga MMPHI përmes një thirrjeje të veçantë për aplikim për nën-projekte.

Konsideratat gjinore do të integrohet në përzgjedhjen e përfituesve përfundimtarë. Kjo përfshin, ndër masa të tjera:

- a) prioritet për familjet me kryefamiljare gra, femra të pamartuara, gratë e papuna dhe të varura ekonomikisht, veçanërisht ato që janë viktime të dhunës seksuale ose dhunës në familje, dhe
- b) duke i dhënë përparësi rasteve kur dokumentet e pronësisë (provat e pronësisë) janë (vetëm ose gjithashtu) në emër të grave.

Mosdiskriminimi në përzgjedhjen e përfituesve përfundimtarë është një parim themelor i projektit.

3. Si të aplikoni

- Formulari i aplikimit duhet të plotësohet në mënyrë dixhitale në formatin e programuar .pdf dhe të nënshkruhet. Nënshkrimi në formatin .pdf mund të vendoset edhe në formë të nënshkrimit dixhital.
- Formularit të plotësuar (digjital dhe fizik) i bashkëngjiten të gjitha dokumentet përkatëse të listuara në faqen **22** të aplikacionit.
- Dosja e plotë e aplikimit dorëzohet në format fizik pranë MMPHI, ish pallati i mediave "Rilindja" 10000 Prishtinë, si dhe njëkohësisht edhe në format dixhital, në këtë e-mail adresë: **drite.m.rama@rks-gov.net**

4. Udhëzime për plotësimin e Formularit të Aplikimit nga Aplikuesit

FORMULARI I APLIKIMIT PËR NËN-PROJEKTIN “RINDËRTIMI I SHTËPIVE PRIVATE PËR FAMILJE APO INDIVIDËT E CENUESHËM”

Kodi i nën-projektit:

[Plotësohet nga NjMP / MMPHI]

PJESA 1: INFORMACIONET E APLIKUESIT

Informacioni i mëposhtëm do të plotësohet:

- 1 Komuna: [Shënoni emrin e Komunës]
- 2 Adresa: [Specifikoni adresën e Komunës]
- 3 Personi kontaktues /Njësia e Implementimit të Projektit (NjIP): [Shënoni emrin e personit kontaktues të caktuar nga Komuna/NjIP]
- 4 Pozita: [Specifikoni pozitën e personit kontaktues brenda Komunës/NjIP-së]
- 5 Email: [Shënoni email-in e personit kontaktues për të gjithë komunikimin që lidhet me këtë aplikacion për nën-projekt]
- 6 Numri i telefonit: [Shënoni numrin e telefonit të personit kontaktues për komunikim në lidhje me këtë aplikacion të nën-projektit]

PJESA 2: FUSHËVEPRIMI I NËN-PROJEKTIT

7. Rindërtimi i shtëpive private për familjet apo individët e cenueshëm

Nën-projekti synon rindërtimin e shtëpive private për popullatën e varfër dhe të cenueshme dhe me qëllim përmirësimin e kushteve të banimit dhe t'i bëjë ato më eficiente nga ana energjetike. Shtëpitë private do të rindërtohen në parcela me pronësi të përcaktuar qartë dhe të pakontestueshme, të verifikuar përmes një certifikate pronësie, e cila është **e detyrueshme** për këtë mbështetje publike. Për më tepër, statusi pronësor i shtëpive do të vlerësohet duke përcaktuar nëse shtëpia është në pronësi të familjes apo individit aplikues.

Shkalla e ndërhyrjes do të bazohet në nivelin e dëmtimit të shtëpive ekzistuese, duke përfshirë rindërtimin e shtëpive që nuk i plotësojnë standardet e banimit dhe që janë dëmtuar rëndë.

Në këtë fazë, duhet të ofrohen të dhënat teknike minimale si më poshtë, megjithëse kjo listë nuk është përfundimtare: numri i përgjithshëm i vlerësuar i shtëpive private që do të rindërtohen; numri i përgjithshëm i vlerësuar i familjeve dhe individëve që banojnë në ato shtëpi; vendndodhja e shtëpive private (urbane, sub-urbane apo rurale); statusi i pronësisë së tokës (nëse familja apo individ mund apo nuk mund të paraqesë certifikatën e pronësisë, apo nëse banon në tokën e dikujt tjetër); statusi i pronësisë dhe i legalizimit të shtëpisë (nëse familja ose individ kërkuar e zotëron apo jo shtëpinë); numri i dhomave⁴; informacione për ndonjë mbështetje të mëparshme

⁴ “Dhomë” konsiderohet dhoma e gjumit, dhoma e ndejës, dhoma e ngrënies, kuzhina, dhoma e bodrumit dhe dhomat e tjera të ndara që përdoren nga familja për banim. “Dhomë” nuk përfshin banjën apo tualetin.

për ato shtëpi nga Fondi i Eficiencës së Energjisë në Kosovë, nëse ka; qasja në infrastrukturë dhe shërbime thelbësore, përfshirë sistemin e kanalizimit, sistemet e ngrohjes, furnizimin me energji elektrike dhe ujë, shërbimet e telekomunikacionit, afërsinë me transportin dhe shërbimet publike, si dhe një vlerësim të përgjithshëm të sigurisë së mjedisit të banimit.

Informacioni do të plotësohet në tabelën e dhënë në Formularin e Aplikimit. Rubrika e komenteve nga kjo pjesë do të përdoret për të dhënë informacion shtesë nëse është e nevojshme.

Kjo përmbledhje do të shoqërohet me informacion të detajuar në SHTOJCËN 1 të formularit të aplikimit, i cili përmban të dhëna specifike për secilën shtëpi private të individit apo familjes së regjistruar në komunë që ka nevojë për rindërtim, si dhe SHTOJCËN 2 – Listë kontrolli treguese mbi kushtet e banimit, bazuar në vlerësimin vizual.

PJESA 3: DETAJET E NËN-PROJEKTIT

8. Kontributi i nën-projektit në zbatimin e politikave dhe strategjive në nivel qendror dhe lokal në fushën e banimit

Aplikacioni për nën-projekt do të detajojë se si fushëveprimi i nën-projektit përputhet me strategjitë dhe politikat lokale dhe kombëtare, duke ofruar informacionin e kërkuar dhe duke zgjedhur të gjitha opsionet përkatëse/të zbatueshme nga lista e dhënë në Formularin e Aplikimit.

☐ Strategjitë/Programet/Planet Lokale në zonën përkatëse.

Shënim: Aplikacioni për nën-projekt do të identifikojë dhe listojë politikat, programet ose planet lokale përkatëse në fushën e banimit social (p.sh., Programi Trevjeçar i Banimit Social).

☐ Strategjitë kombëtare:

☐ Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 (SKZH)⁵.

☐ Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022-2026)⁶.

☐ Strategjia për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026⁷.

☐ Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019-2028⁸.

☐ Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031⁹.

⁵ <https://kryeministri.rks-gov.net/strategjia-kombetare-per-zhvillim-2030/>

⁶ <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ALB-Strategjia-Kombe%CC%88tare-pe%CC%88r-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne%CC%88-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-%E2%80%93-2026.pdf>

⁷ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/05/Strategjia-per-avansimin-e-te-drejtave-te-komuniteteve-rom-dhe-ashkali-ne-Republiken-e-Kosoves-2022-2026-dhe-Plani-i-veprimit-2022-2024.pdf>

⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=29356>

⁹ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/03/Strategjia-e-Energjise-e-Republikes-se-Kosoves-2022-2031.pdf>

Strategji/politika të tjera relevante do të përfshihen në Formularin e Aplikimit sipas nevojës në pjesën e dedikuar.

9. Numri i parashikuar i përgjithshëm i familjeve dhe individëve në nevojë në Komunë që kanë nevojë për përmirësime në shtëpi

9.1 Kjo pjesë kërkon dhënien e informacionit mbi **numrin e përgjithshëm të parashikuar të familjeve dhe individëve të cënueshëm** në Komunë që kanë nevojë për rindërtim të shtëpive siç tregohet nga të dhënat në dispozicion (p.sh., dosjet e rasteve / kërkesave) në Komunë.

Mbështetja e ofruar në kuadër të Komponentit 2 të PBSA-së **Përmirësimi i shtëpive private** synon të renovojë ose rindërtojë shtëpitë private për familjet dhe individët në nevojë, duke i bërë ato më të përshtatshme për jetesë dhe duke rritur efikasitetin e tyre energjetik.

- ⇒ Numri i përgjithshëm i vlerësuar aktual i familjeve dhe individëve të cënueshëm në komunë që kanë nevojë për përmirësime në shtëpi (ose renovim ose rindërtim), siç tregohet nga të dhënat në dispozicion (p.sh., dosjet e rasteve/kërkesave) në Komunë, identifikohet në pikën 9.1 të formularit të aplikimit.

Shënoni të dhënat në tabelën e Formularit të Aplikimit siç kërkohet në pikën 9.1.1 të Formularit të Aplikimit.

Të dhënat janë të nevojshme për të vlerësuar ndikimin social të pritur të nën-projektit pas përfundimit të tij dhe merren në konsideratë në llogaritjet sipas pikës 20.1, Pjesa 6: Ndikimi Social dhe Mjedisor.

9.2 Shënoni informacion të detajuar mbi aspektet e mëposhtme në lidhje me përfituesit potencialë të cënueshëm të cilët do të përfitojnë drejtpërdrejt nga rindërtimi i shtëpive sipas këtij nën-projekti, sipas të dhënave në dispozicion (p.sh., dosjet e kërkesave) në Komunë.

Përfituesit potencialë – janë ata individë dhe familje që preken drejtpërdrejt nga zbatimi dhe rezultatet e nën-projektit, dhe që potencialisht përfitojnë nga mbështetja për rindërtimin e shtëpive private nga ky nën-projekt.

- ⇒ Në këtë pjesë, aplikimi për nën-projekt do të identifikojë dhe përshkruajë numrin total të përfituesve të mundshëm, duke përfshirë familjet dhe individët, që janë të përfshirë drejtpërdrejt nga zbatimi dhe rezultatet e nën-projektit, duke përfshirë informacion mbi **kategoritë e grupeve të cënueshme**, situatën ekonomike, përbërjen e familjes dhe karakteristikat gjinore.

Numri i përgjithshëm i vlerësuar i përfituesve potencialë të nën-projektit, i përmendur në pikën 9.2.1, do të llogaritet nga numri i përgjithshëm i familjeve dhe individëve të cënueshëm në komunë që kanë nevojë për përmirësim të kushteve të banimit (qoftë përmes renovimit apo rindërtimit), siç është përcaktuar në pikën 9.1.1 të aplikacionit për nën-projektin.

Numri i vlerësuar i familjeve dhe individëve të cënueshëm që pritet të përfitojnë nga nën-projekti, përfshirë ndarjet e kërkuara sipas kategorive, do të paraqitet në pikën 9.2 të aplikacionit për nën-projektin.

Është e rëndësishme të përfshihen edhe parashikimet për numrin e femrave (gra dhe vajza) të prekura nga nën-projekti dhe të specifikohen ato që kanë dokumente pronësie të shtëpive në emrin e tyre, siç kërkohet respektivisht në pikën 9.2.5, nën-pikat a. dhe a.1., nëse të dhënat janë të disponueshme.

Situata ekonomike e familjeve dhe individëve të cënueshëm që do të përfitojnë nga nën-projekti do të vlerësohet bazuar në nivelin e të ardhurave, të kategorizuara si vijon:

Kategoria 1 – të varfër ekstrem

Kategoria 2 – të varfër

Këto kategori përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm te përfituesit e Skemës së Ndhmës Sociale për një periudhë minimale prej një viti dhe përfituesit me të ardhura mujore deri në 100 euro për çdo anëtar të familjes.

Komuna, në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale, do të vlerësojë statusin ekonomik të përfituesve duke përdorur verifikimin e të ardhurave ose testin e varfërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10. Përmbledhje e sfidave aktuale të Komunës në rindërtimin e shtëpive private për familjet dhe individët më të cënueshëm dhe më të varfër, si dhe përfitimet kryesore të pritura si rezultat i zbatimit të masave të nën-projektit.

10.1 Në këtë pjesë, në Formularin e Aplikimit do të jepet një përshkrim narrativ i **sfidave aktuale të Komunës në rindërtimin e shtëpive private** për familjet dhe individët më të cënueshëm dhe më të varfër, **me një maksimum prej 250 fjalësh.**

⇒ Komuna mund të përballet me sfida të ndryshme në rindërtimin e shtëpive private, duke përfshirë, por pa u kufizuar në financim të pamjaftueshëm, pengesa burokratike, mungesë të fuqisë punëtore të kualifikuar në ndërtim dhe materiale ndërtimi, rritje të kostove të ndërtimit, kufizime institucionale në shtrirjen dhe identifikimin e atyre që kanë nevojë për mbështetje rindërtimi, barriera kulturore dhe komunikimi e kështu me radhë. Kur është e aplikueshme, sfidat do të dokumentohen duke iu **referuar të dhënave statistikore përkatëse dhe dokumenteve të tjera në dispozicion.**

10.2 Përveç kësaj, opsionet përkatëse të listuara në formular do të shënohen, dhe/ose do të shtohen propozime të tjera përkatëse që **nuk janë të përfshira në listë, nëse është e nevojshme, për të pasqyruar përfitimet specifike të nën-projektit.**

⇒ Përfitimet kryesore të parashikuara nga masat e zbatuara të nën-projektit mund të përfshijnë, por pa u kufizuar vetëm në to, përmirësimin e kushteve të jetesës; zbatimin e proceseve

jodiskriminuese dhe të ndjeshme ndaj gjinisë në projektimin e njësive të banimit dhe përzgjedhjen e përfituesve; krijimin e praktikave të qëndrueshme mjedisore, si dhe krijimin e procedurave komunale të përzgjedhjes së përfituesve. Propozime të tjera të përshtatura për nevojat e nën-projektit do të shtohen sipas nevojës.

11. Përshkrim i shkurtër i zbatimit të nën-projektit

Në këtë pjesë, nën-projekti do të paraqesë një përmbledhje të shkurtër, duke u përqendruar në aspektet kyçe, por jo të kufizuara vetëm në to:

11.1 Shënoni kohëzgjatjen e parashikuar të nën-projektit duke plotësuar hapësirat boshe brenda kllapave.

Nën-projekti përfshin numrin total të shtëpive private të planifikuara për rindërtim sipas kësaj thirrjeje për aplikim për nën-projekte. Prandaj, kohëzgjatja pasqyron kohën maksimale të nevojshme për të përfunduar të gjithë rindërtimin e të gjitha këtyre shtëpive.

11.2 Përshkruani fazat kryesore, kohëzgjatjen e parashikuar dhe çdo moment të rëndësishëm (p.sh., planifikimin, prokurimin, ndërtimin, mbikëqyrjen dhe përfundimin).

Planifikimi do të përfshijë një vlerësim kohor real për secilën fazë dhe proces të përfshirë në zbatimin e aktiviteteve të nën-projektit.

Planifikimi do të përfshijë një kohë minimale prej dy javësh të caktuar për MMPHI-në për të shqyrtuar dokumentet e tenderit dhe për të marrë "pa kundërshtim/no objection" të kërkuar nga BZHKE/CEB.

11.3 Specifikoni çdo rrezik të rëndësishëm social, mjedisor, klimatik dhe operativ dhe masat zbutëse të parashikuara si rezultat i zbatimit të nën-projektit. Ato mund të përfshijnë këto lloje të rreziqeve:

- ⇒ **Rreziqet sociale** i referohen, ndër të tjera, të drejtave dhe kushteve të punëtorëve, përfshirë punën e detyruar dhe punën e fëmijëve, çështjet e shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës dhe në komunitet, nevojën për informim dhe konsultim me palët e interesit – veçanërisht me popullsinë vulnerabël që ka nevojë për përmirësim të kushteve të banimit – si dhe diskriminimin mbi baza gjinore apo forma të tjera të diskriminimit, përfshirë fazat e ndërtimit dhe pas-ndërtimit.
- ⇒ **Rreziqet mjedisore** u referohen efekteve të dëmshme që lidhen me ndërtimin, duke përfshirë ndotjen e ajrit, zhurmën, cilësinë e ujit, ndotjen e tokës, menaxhimin e mbeturinave, humbjen e biodiversitetit, ndryshimin e peizazhit dhe përdorimin e materialeve të rrezikshme ose toksike.

- ⇒ **Rreziqet klimatike** burojnë nga ngjarjet atmosferike, përfshirë përmytjet apo kushte të tjera ekstreme klimatike.
- ⇒ **Rreziqet operationale** mund të përfshijnë, ndër të tjera, vonesa në aktivitetet apo proceset e prokurimit dhe ndërtimit, tejkalime të mundshme të kostove, mosrespektim gjatë zbatimit të punimeve, dhe çështje të tjera që burojnë nga procesi i zbatimit të nën-projektit.

Faktorët e identifikuar që mund të kenë ndikim negativ në zbatimin e nën-projektit dhe në rezultatet e pritshme të tij konsiderohen si “rreziqe” për nën-projektin. Identifikimi i hershëm i rreziqeve të mundshme i mundëson nën-projektit t’i adresojë ato përmes masave të propozuara të zbutjes, në koordinim me palët përkatëse të interesit.

PJESA 4: KËRKESAT PËR FINANCIM

- 12 Kostoja totale e vlerësuar e nënprojektit (EUR):** [Vendosni koston totale, duke përfshirë burimet qeveritare, komunale ose burime të tjera, nëse ka].
- 13 Shuma e kërkuar nga Financuesi – MESPI (EUR)** do të shënohet.
- 14 Buxheti i disponueshëm i Komunës /viti fiskal dhe planet e ardhshme (EUR)** do të shënohet.
- 15 Burime të tjera financimi në EUR (nëse ka)** do të shënohen.
- 16 Arsytimi për fondet e kërkuara.** Do të jepet një justifikim për kërkesën për financim, duke përfshirë një shpjegim të kostove të përfshira për të mbështetur përcaktimin e kostos.

Kjo pjesë kërkon detajimin e koston totale të vlerësuar në euro, burimeve të financimit, siç janë ato nga Niveli Qendror - MMPHI, Komuna ose burime të tjera, dhe planifikimin financiar. Kostot e parashikuara në buxhet do të bazohen në konceptin e projektit, vlerësimet për tokën dhe elemente të ngjashme. Këto lloj kostosh do të koordinohen me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), për të siguruar përputhshmëri me prioritetet e buxhetit kombëtar, planifikimin e infrastrukturës dhe fizibilitetin financiar. Komuna duhet të sigurojë që buxheti i nën-projektit të mbulojë të gjitha kostot e nevojshme për një zbatim të suksesshëm, me përshkrime të qarta të kostove. Çdo zë buxhetor duhet të justifikohet, duke demonstruar arsyeshmërinë dhe lidhjen e drejtpërdrejtë të tij me fushëveprimin e nën-projektit.

PJESA 5: KAPACITETET MENAXHUESE

17 Personeli komunal për zbatimin e nën-projektit, duke përfshirë planifikimin dhe themelimin e Njësitit të Implementimit të Projektit (NJIP)

Ekipi i projektit (NJMP) do të përfshijë një numër të mjaftueshëm personeli, duke përfshirë të paktën një koordinator projekti, profesionistë social/ligjor dhe inxhinierë të ndërtimit/projektues të cilët gjithashtu mund të adresojnë çështje mjedisore në lidhje me aktivitetet e propozuara të nënprojektit. Eksperti mjedisor duhet të zotërojë certifikimet e nevojshme në përputhje me kërkesat ligjore.

Në këtë pjesë do të ofrohen informacionet e mëposhtme:

- ⇒ Numri tregues i personelit të propozuar për nën-projektin, duke përfshirë personelin e planifikuar të NjIP-së
- ⇒ Për secilin pozicion do të ofrohen të dhënat e mëposhtme:
 - Titulli i pozitës
 - Përvoja minimale relevante për nën-projektin, duke përfshirë vitet
 - Lloji i angazhimit: Orar i plotë/Gjysmë-orar
 - Statusi i punësimit: Staf internal/I punësuar/Do të punësohet - kontraktohet

Jepni informacion në Formularin e Aplikimit që pasqyron specifikat e nën-projektit sipas kërkesës.

18 Kapaciteti i prokurimit

Në këtë pjesë do të ofrohen informacionet e mëposhtme:

- ⇒ Numri tregues i personelit të propozuar për nën-projektin
- ⇒ Për secilin pozicion do të ofrohen të dhënat e mëposhtme:
 - Titulli i pozicionit
 - Lloji i angazhimit: Orar i plotë/Gjysmë-orar
 - Statusi i punësimit: Staf internal/I punësuar/Do të punësohet - kontraktohet

Jepni informacion në Formularin e Aplikimit që pasqyron specifikat e nën-projektit sipas kërkesës.

19 Kontrata (kornizë) të disponueshme për projektim, mbikëqyrjes dhe shërbimeve të ngjashme

Në këtë pjesë, specifikoni nëse Komuna ka kontrata projektimi, mbikëqyrje ose kontrata të tjera të ngjashme shërbimesh duke shënuar opsionet përkatëse ose duke plotësuar fushat e kërkuara. Projektimi dhe mbikëqyrja do të jepen me kontratë nga jashtë dhe nuk mund të kryhen nga stafi i Komunes.

Jepni informacion në formularin e aplikimit që pasqyron specifikat e nënprojektit sipas kërkesës.

PJESA 6: NDIKIMI SOCIAL DHE MJEDISOR

20 Ulja e pritur në përqindje e nevojave/kërkesës së përgjithshme për rindërtim të shtëpive private midis popullsisë më të cënueshme dhe më të varfër në komunë si rezultat i drejtpërdrejtë i zbatimit të nën-projektit

Llogaritja e përqindjes do të kryhet në përputhje me udhëzimet e specifikuar në formularin e aplikimit.

21 Përqindja e pritur e përfitueseve femra të prekura nga nën-projekti

Kjo kërkesë i referohet llogaritjes së përqindjes së parashikuar të përfitueseve potenciale gra, duke përfshirë familjet e udhëhequra nga gratë, gratë e papuna, gratë e varura ekonomikisht,

gratë me të ardhura të ulëta, femrat e pamartuara dhe ato që kanë përjetuar dhunë seksuale ose dhunë në familje, cenueshmëria e të cilave do të jetë zvogëluar si rezultat i nën-projektit.

Llogaritja e përqindjes do të kryhet në përputhje me udhëzimet e specifikuara në formularin e aplikimit.

22 Ndikimi Social (p.sh., përmirësimi i kushteve të jetesës, zvogëlimi i mungesës së njësive të banimit dhe cenueshmërisë).

- ⇒ Parandalimi i mungesës së banimit do të përqendrohet në masat afatgjata të sigurisë së banimit për familjet e cenueshme, veçanërisht familjet me kryefamiljare gra dhe anëtare të tjera femra të familjes (gra dhe vajza) në rrezik varfërie, dëmtimi dhe diskriminimi.
- ⇒ Ulja e cenueshmërisë do të adresojë problemet e varfërisë, energjisë dhe shëndetit për familjet dhe individët e nënpërfaqësuar.
- ⇒ Kushtet e jetesës më të dinjitetshme do të arrihen, ndër të tjera, përmes ofrimit të banimit dhe mjedisit të sigurt e të qasshëm, përfshirë banimin e përshtatshëm që plotëson nevoja specifike dhe i përshtatet rrethanave jetësore në ndryshim, si dhe përmes sigurimit të qasjes në shërbimet dhe infrastrukturën thelbësore.

Vini re se opsionet përkatëse do të shënohen në tabelën e përfshirë në formularin e aplikimit, së bashku me dhënien e çdo informacioni shtesë të nevojshëm.

23 Ndikimi mjedisor

Përrshkruani ndikimin mjedisor të nën-projektit në komunitetin lokal, ekosistemin dhe habitatin.

Vini re se opsionet përkatëse do të shënohen në tabelën e përfshirë në formularin e aplikimit, së bashku me dhënien e çdo informacioni shtesë të nevojshëm.

24 Zgjidhje moderne të qëndrueshme për shtëpi private (dmth. masa për kursimin e energjisë; zgjidhje banimi të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike dhe të përshtatshme për kushtet në ndryshim, si dhe praktika mjedisore të qëndrueshme).

Në këtë pjesë, do të ofrohen informacionet e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to

- ⇒ Zbatimi i zgjidhjeve të banimit me efikasitet energjetik për të ulur konsumin dhe kostot e energjisë, si dhe integrimi i sistemeve të kursimit të ujit për të minimizuar përdorimin e burimeve.
- ⇒ Optimizimi i dizajnit për dritë natyrore dhe ventilim, me qëllim të zvogëlimit të varësisë nga ndriçimi, ngrohja dhe ftohja artificiale.
- ⇒ Përfshirja e masave të qëndrueshmërisë dhe përshtatjes për të zbutur rreziqet e lidhura me ndryshimet klimatike (p.sh. valët e të nxehtit dhe përmytjet).

Vini re se opsionet përkatëse do të shënohen në tabelën e përfshirë në formularin e aplikimit, së bashku me dhënien e çdo informacioni shtesë të nevojshëm.

PJESA 7: APROVIMET EVENTUALE / PËLQIMET / LEJET

25 Informacion mbi statusin e miratimeve/lejeve dhe pëlqimeve ekzistuese

Në këtë pjesë do të jepet informacion, por pa u kufizuar vetëm në të, mbi aprovimet e marra, përfshirë ato për shërbimet komunale, lejen e ndërtimit dhe të tjera, sipas rastit.

Vini re se opsionet përkatëse do të shënohen në tabelën e përfshirë në formularin e aplikimit, së bashku me dhënien e çdo informacioni shtesë të nevojshëm, nëse është e nevojshme.

26 Informacion mbi vendimet e nevojshme të miratuara dhe masat e ngjashme për nën-projektin

Në këtë pjesë do të shënohet informacion në lidhje me vendimet e Kuvendit Komunal në lidhje me nën-projektin.

Vini re se detajet do të shënohen në formularin e aplikimit.

27 Informacion mbi parakushtet e përmbushura dhe kufizimet e mbetura

Ju lutemi vini re se opsionet përkatëse do të shënohen në tabelën e dhënë në formularin e aplikimit.

Është e detyrueshme që parcela në të cilën ndodhet shtëpia private të ketë certifikatë të vlefshme pronësie.

SHTOJCA 1: Parametrat kryesorë për secilën dosje individuale të regjistruar në Komunë që ka nevojë për rindërtim të shtëpive përmes këtij nën-projektit¹⁰		
Shënoni detaje për secilën shtëpi private duke shënuar opsionet e duhura dhe/ose duke dhënë informacionin e kërkuar:		
Shënoni numrin e dosjes së kërkesës nga lista e përfituesve të mundshëm familje dhe individë: _____		

Adresa e shtëpisë: <i>Shënim: Mund të përfshijë numrin e shtëpisë, si dhe një adresë vendndodhjeje/link nga Google Maps</i>	Specifikoni adresën: _____ _____	
(Zgjidhni opsionin përkatës dhe/ose shënoni informacionin e kërkuar)		
1. Vendndodhja e shtëpisë private:	☐ Urbane:	
	☐ Sub-urbane:	
	☐ Rurale:	
2. Numri aktual i anëtarëve të familjes, me ndarje gjinore:	Specifikoni numrin e anëtarëve: _____	
	Specifikoni numrin e individëve femra: _____	
	Specifikoni numrin e individëve meshkuj: _____	
3. Kushtet ekonomike sipas dosjes së kërkesës:	☐ Kategoria I – të varfër ekstrem	Shënoni detaje: _____ _____ _____ _____
	☐ Kategoria II - të varfër	
4. Statusi i pronësisë së truallit ku ndodhet shtëpia që ka nevojë për rindërtim:	☐ Po – Familja/individ mund të paraqesë certifikatë pronësie. <i>Dëshmia e pronësisë duhet të paraqitet si shtojcë</i>	
	☐ Jo – Familja/individ nuk mund të paraqesë certifikatë pronësie.	
	☐ Jo – Familja/individ jeton në truallin e dikujt tjetër	

¹⁰ Shtoni sa më shumë shtëpi të jetë e mundur që i nënshtrohen rindërtimit të shtëpive familjare përmes nën-projektit, duke ndjekur formatin e dhënë.

5. Statusi i pronësisë së shtëpisë:	☐ Po – Shtëpia është zyrtarisht në pronësi të familjes/individit/individëve kërkues. <i>Dëshmia e pronësisë duhet të paraqitet si shtojcë</i>
	☐ Jo – Shtëpia nuk është zyrtarisht në pronësi të familjes individëve kërkues. Shënoni komente: _____ _____ _____
6. Posedimi i dokumentit të legalizimit:	☐ Po – Shtëpia është legalizuar
	☐ Jo – Shtëpia nuk është legalizuar ☐ Shtëpia është në proces të legalizimit Shënoni detaje: _____ _____
7. Madhësia dhe numri i dhomave në shtëpi ¹¹	Shënoni sipërfaqen bruto - madhësia në m ² : _____
	☐ Një dhomë
	☐ Dy dhoma
	☐ Tre dhoma
	☐ Katër+ dhoma
8. Viti/periudha e ndërtimit të shtëpisë:	Shënoni detaje: _____ _____
9. Vlera treguese e shtëpisë, nëse është e disponueshme:	Shënoni detaje: _____ _____
10. Kushtet e banimit - Shkalla e dëmtimit: <i>Shënim: Plotësoni Shtojcën 2: Lista treguese e kontrollit mbi kushtet e banimit</i>	☐ Më shumë se 60% - e pabanueshme

¹¹ Numri i dhomave ("Dhomë" konsiderohet dhoma e gjumit, dhoma e ndenjes, dhoma e ngrënies, kuzhina, dhoma e bodrumit dhe dhoma të tjera të veçanta që përdoren nga familja për jetesë. "Dhomë" nuk përfshin banjon ose tualetin.

11. Rilevimi gjeodezik-topografik i vendndodhjes ku ndodhet shtëpia për zhvillimin e nën-projektit	☐ Po – do të ofrohet ☐ Jo
12. Vlerësim i dukshëm strukturor, nëse ka: <i>Shënim: Nëse keni, bashkëngjitini foto të fundit nga brenda dhe jashtë shtëpisë.</i>	Shënoni detaje:
13. Kapacitetet e infrastrukturës dhe shërbimeve ekzistuese, nëse ka të dhëna të disponueshme:	Shënoni detaje mbi kapacitetet e infrastrukturës dhe shërbimeve ekzistuese (p.sh., shpejtësia e rrjedhjes së ujit, kapacitetet e ngarkesës së energjisë elektrike, kapaciteti i kanalizimeve, etj.).
14. Ndërhyrjet e mëparshme të renovimit ose rindërtimit të shtëpisë, nëse ka pasur:	Ndërhyrjet në shtëpi të iniciuara nga pronari: ☐ Po Viti / vitet: _____ ☐ Jo Nëse po, shënoni detaje mbi llojet e ndërhyrjeve dhe statusin e ekzekutimit: Ndërhyrjet e kryera nga palë të ndryshme, përfshirë (emrat) ☐ Po Viti / vitet: _____ ☐ Jo Nëse po, shënoni detaje mbi llojet e ndërhyrjeve dhe statusin e ekzekutimit:

15. Shtëpia përfitoi nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE):	☐ Po: shënoni detaje mbi vitet dhe nivelin e ndërhyrjeve më poshtë: _____	
	☐ Jo	
16. Qasja në sistemin e kanalizimeve:	☐ I lidhur me kanalizimet publike/komunale	
	☐ Gropë septike	
	☐ Pa kanalizim	
17. Sistemi i ngrohjes:	☐ Qendrore – Komunale	
	☐ Qendrore – Individuale	
	☐ Sobë druri ose ngrohje e ngjashme	
	☐ Pa sistem ngrohjeje	
18. Furnizimi me energji elektrike:	☐ I lidhur me rrjetin qendror të energjisë	
	☐ Mundësuar nga panelet diellore ose burime alternative	
	☐ Nuk ka qasje në rrjetin e energjisë elektrike	
19. Furnizimi me ujë:	☐ I lidhur me infrastrukturën publike/komunale	
	☐ Pus privat	
	☐ Pa qasje në burime uji të pastër	
20. Qasja në menaxhimin e mbeturinave:	☐ Qasja në shërbimet e mbledhjes dhe grumbullimit të mbeturinave	
	☐ Nuk ka qasje në shërbim për mbledhjen ose asgjësimin e mbeturinave	
21. Qasje në telekomunikacion:	Opsionet e internetit (kabllor/mobile broadband):	☐ Po
		☐ Jo
	Celular/Fiks:	☐ Po
		☐ Jo
22. Vlerësimi i përgjithshëm i qasshmërisë – afërsia me transportin, lehtësitë dhe shërbimet publike:	Qasje në rrugë publike:	☐ Po
		☐ Jo

	Stacionet e autobusëve publikë:	☐ Po
		☐ Jo
	Shtigjet për këmbësorë:	☐ Po
		☐ Jo
	Korsi për biçikleta (duke përfshirë edhe skuterët/biçikletat elektrike):	☐ Po
		☐ Jo
	Qasja në shërbimet shëndetësore, arsimore dhe të kujdesit:	☐ Po
		☐ Jo
	Qasje në hapësirat publike dhe zonat e gjelbra; dyqanet dhe shërbime në afërsi që mbështesin jetën komunitare:	☐ Po
		☐ Jo
	Vendndodhje e largët ose e izoluar e shtëpisë:	☐ Po
		☐ Jo
23. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë së mjedisit jetësor:	Ndriçimi Publik:	☐ Po
		☐ Jo
	Qasshmëria për Personat me Nevoja të Veçanta:	☐ Po
		☐ Jo
	Masa të tjera sigurie (Shënoni detaje):	
24. Tregoni çdo konsideratë, kufizim ose koordinim të veçantë të kërkuar:	Shënoni detaje:	

SHTOJCA 2: Listë kontrolli treguese mbi kushtet e banimit në shtëpitë private për familjet ose individët e cënueshëm, bazuar në inspektimin vizual

Komuna: _____

Pronari/ja apo përdoruesi/ja i shtëpisë private: _____

Adresa e shtëpisë: _____

Të dhënat kadastrale (nëse ka): _____

Viti i ndërtimit: _____

Dokumentacioni i ndërtimit: ☐ Po ☐ Jo

Leja e përdorimit: ☐ Po ☐ Jo

Karakteristikat	Shënoni opsionin përkatës dhe jepni informacion
Lloji i çatisë	☐ standard tradicional ☐ pllakë e sheshtë
Gjendja e çatisë	☐ mirë - e pranueshme ☐ e dëmtuar rëndë ☐ jashtëzakonisht e dëmtuar
Lloji i mureve	☐ tullë ☐ gurë ☐ beton Tjetër _____ _____
Gjendja e mureve	☐ mirë - e pranueshme ☐ të dëmtuara rëndë ☐ jashtëzakonisht të dëmtuara
Lloji i ndërtimit	☐ tradicional ☐ bashkëkohor
Gjendja e ndërtimit	☐ mirë - e pranueshme ☐ i dëmtuar rëndë ☐ jashtëzakonisht i dëmtuar
Gjendja e shkallëve (nëse ka)	☐ mirë - e pranueshme ☐ dëmtim i rëndë ☐ jashtëzakonisht të dëmtuara

Gjendja e hapjeve (arkitrari, devijimi)	☐ mirë - e pranueshme ☐ të dëmtuara rëndë ☐ jashtëzakonisht të dëmtuara
Gjendja e pllakës/pllakave të dyshemesë (nëse ka)	☐ mirë - e pranueshme ☐ të dëmtuara rëndë ☐ jashtëzakonisht të dëmtuara
Gjendja e themeleve	☐ mirë - e pranueshme ☐ të dëmtuara rëndë ☐ jashtëzakonisht të dëmtuara
Problemet me rrëshqitjet e tokës	☐ Po
	☐ Jo
Dëme nga uji	☐ Po
	☐ Jo
Dëmtime nga zjarri	☐ Po
	☐ Jo
Dëmet nga lufta e fundit	☐ Po
	☐ Jo
Përshkrimi i dëmeve nga lufta (nëse ka)	Shënoni detaje:
Nevojitet ekzaminim shtesë ndërtimi (statik)	☐ Po
	☐ Jo
Përfundime dhe detaje të tjera	Shënoni detaje:

Data e inspektimit: _____

Emri i arkitektit / inxhinierit: _____

PJESA 8: DEKLARATË NGA KOMUNA

Unë, i nënshkruari/a, konfirmoj se informacioni i dhënë në këtë aplikim është i saktë dhe i plotë.

Unë e kuptoj që çdo deklaratë e pavërtetë mund të rezultojë në refuzimin e këtij aplikimi.

Emri: _____ Pozicioni: _____

Nënshkrimi: _____ Data: _____

PJESA 9: MIRATIMI NGA MMPHI/NJMP

Pëlqimi me Modelin/Metodën e Implementimit siç është hartuar nga MMPHI/NJMP:

☐ Po ☐ Pjesërisht (plotësim dokumentacioni / informacioni)

• Emri Mbiemri: _____ Pozita: _____

• Nënshkrimi: _____ Data: _____

DOKUMENTET QË DUHET T'I BASHKËNGJITEN FORMULARIT TË APLIKIMIT:

1. Vendim për themelimin e Njesisë së Implementimit të Projektit (NjIP)
2. Përshkrimi i kontratave kornizë për shërbimet e projektimit, mbikëqyrjes dhe ndërtimit (nëse ka), duke përfshirë periudhën e vlefshmërisë dhe kapacitetin për të mbuluar shërbimet për nën-projektin (në € ose m²).
3. Certifikata(t) e pronësisë dhe një kopje e planit kadastral për shtëpinë(të) e propozuara për zhvillimin e nën-projektit – rindërtim.
4. Dokument legalizimi i shtëpisë private ose prova që shtëpia është në proces legalizimi, kur është e aplikueshme.
5. Raporti vizual dhe përshkrimor i gjendjes ekzistuese të shtëpisë / shtëpive që do të rindërtohen, duke treguar dhe përshkruar pozicionet dhe komponentët
6. Buxheti i detajuar i vlerësuar i nën-projektit (kostot e shërbimeve dhe investimit, përfshirë ndarjen e shumës së kërkuar nga MMPHI për punimet e renovimit, shpenzimet për NjIP-në, projektimin, mbikëqyrjen, kostot e tjera përkatëse dhe burime të tjera financimi).
7. Dëshmi për burime të tjera financimi (nëse ka).
8. Lista paraprake ose përfundimtare e përfituesve të mundshëm, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave.
9. **Shtojca 1 Parametrat kyç** dhe **Shtojca 2 Lista e kontrollit tregues mbi kushtet e banimit** për secilën dosje/kërkesë të regjistruar në komunë që ka nevojë për rindërtim shtëpie përmes këtij nën-projekti.
10. Çdo dokument tjetër relevant, të listohet më poshtë

5. PROCESI I VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE PËR NËN-PROJEKTE

5.1 Verifikimi, vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve për nën-projekte

Verifikimi i përshtatshmërisë së aplikimeve për nën-projekte nga Komuna do të bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2 të këtij Udhëzuesi.

Vlerësimi dhe përzgjedhja e aplikimeve për nën-projekte përfshin një vlerësim cilësor të bazuar në kriteret objektive dhe shumë-dimensionale të Aplikimit dhe të gjithë informacionit përkatës të dorëzuar gjatë Procesit të Aplikimit.

Kriteret e Vlerësimit janë paraqitur në Tabelën e Vlerësimit dhe Përzgjedhjes (Shtojca 1 dhe 2) të këtij Udhëzuesi për Aplikim.

5.2 Vendimi i MMPHI-së

5.2.1 Njoftimi i rezultateve

MMPHI do t'i njoftojë Aplikuesit me shkrim për rezultatin e aplikimit të tyre, duke përfshirë edhe arsyet në rast të një vendimi për refuzimin e aplikimit.

5.2.2 Marrëveshja ne mes te MMPHI dhe bashkive për nënprojektet e përzgjedhura (që do të plotësohet nga MMPHI)

6. ADMINISTRIMI

6.1 Ndryshimi i Udhëzimeve

MMPHI mund të rishikojë, shfuqizojë ose ndryshojë këto udhëzime në çdo kohë dhe pa njoftim paraprak. Në rast se këto udhëzime do të modifikohen apo ndryshohen, versioni i rishikuar do të publikohet në faqen zyrtare të MMPHI-së.

6.2 Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale - MMPHI

Të dhënat e ofruara në Aplikacionet për nën-projekte dhe informacioni pasues i marrë nga MMPHI në kuadër të Projektit të Banimit Social Adekuat do të trajtohen si konfidenciale.

Projekti i Banimit Social Adekuat do t'i trajtojë të dhënat personale të përfshira në një aplikim në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Duke dorëzuar Formularin e Aplikimit dhe çdo dokument tjetër pasues, Aplikuesi jep pëlqimin që Projekti i Banimit Social Adekuat të përdorë dhe të zbulojë informacionin e dorëzuar si pjesë e aplikimit për qëllime të administrimit dhe vlerësimit të aplikimit.

Aplikuesit gjithashtu pranojnë se mund të ndodhë zbulimi i informacionit kur kjo është e autorizuar ose e kërkuar me ligj, apo kur informacioni tashmë është i disponueshëm në domenin publik.

6.3 Konflikti i interesit - MMPHI

Konfliktet e interesit mund të ndikojnë negativisht në performancën, integritetin dhe zbatimin e nën-projektit të Komunës si pjesë e Projektit të Banimit Social Adekuat (PBSA).

Aplikuesit do të kërkohet të deklarojnë, si pjesë e aplikimit të tyre, çdo konflikt interesi të perceptuar, të mundshëm ose ekzistues, ose të konfirmojnë se, sipas njohurive të tyre më të mira, nuk ekziston ndonjë konflikt interesi.

Projekti i Banimit Social Adekuat do të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për të menaxhuar në mënyrë të duhur çdo konflikt interesi dhe për të siguruar që vlerësimi dhe marrja e vendimeve në lidhje me aplikimet të bëhen paanshmërisht.

6.4 Pajtueshmëria - MMPHI

Aplikimet e suksesshme do të kërkohet të përmbushin detyrimet për raportim dhe performancë të përcaktuara në Marrëveshjen ndërmjet Komunës dhe MMPHI-së në kuadër të Projektit për Banim Social të Përshtatshëm, si dhe kuadrin përkatës ligjor dhe rregullativ.